



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

### NJOFTIM PËR PUNËSIM

Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Q.S.U “Nënë Tereza” kërkon të punësojë **1 (një) Specialist në Sektorin e Prokurimeve, të Drejtorisë Juridike, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”**.

**Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët janë:**

- Arsimit i lartë, profil Juridik/ Ekonomik. *Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;*
- Të ketë përvojë pune në profilin e kërkuar;
- Të ketë mbrojtur gjuhën angleze;
- Të përmbushë në kohë dhe me korrektësi detyrat e ngarkuara;
- Njohuri të gjera të kuadrit ligjor në fuqi në përgjithësi e vecanërisht të prokurimeve publike;
- Aftësi dhe fleksibilitet në përditësimin e procedurave të reja konform ndryshimeve ligjore;
- Aftësi të mira komunikimi.

**Për sa më sipër, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentata në gjuhën shqipe si më poshtë:**

1. Kërkesa me shkrim e shoqëruar me fotokopje e dokumentit të identifikimit (ID)
2. Curriculum vitae (CV) në gjuhën shqipe ku të jetë edhe adresa e postës elektronike (e-mail)
3. Diploma e arsimit të lartë, e noterizuar
4. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)
5. Formulari i Vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore (link: <http://www.qsut.gov.al/rreth-nesh-8/te-punosh-me-ne/procedurat-e-marrjes-ne-pune-ne-qsut/>)
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet apo të tjera të përmendura në CV dhe që lidhen me pozicionin për të cilin aplikon.

Depozitimi i aplikimeve do të bëhet pranë zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e QSU “Nënë Tereza” duke nisur nga data **24.01.2022 ora 08:00** deri më **07.02.2022 ora 16:30**.

Komunikimi për datën dhe orën e Intervistave do të bëhet nëpërmjet **e-mail**-it në CV e kandidatëve.

Të gjithë kandidatët fitues do të rivlerësohen në fund të kontratës 3 (tre) mujore.

**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**